



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.88/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 28.02.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me Nr.REF-47664-01-17-2020 me objekt Loti 2 “*Mbetje spitalore qe perfshin kodin 180102 mbetje humane etj*”, me fond limit 481 200 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me Nr.REF-47662-01-17-2020 me objekt Loti 1 “*Mbetje spitalore qe perfshin kodin 180101 dhe 180103 age, bisturi etj*”, me fond limit 7,410,000 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

Ankimues: “V.A.L.E Recycling” shpk
Fushë Kuqe, Gurrëz, afër ish kanalit të acidit Lezhë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat
Lagjia “Kushtrim” Berat

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” .

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këto procedura prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me to, bazuar në pikën 1 të nenit 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.01.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me Nr.REF-47664-01-17-2020 me objekt Loti 2 “*Mbetje spitalore që përfshin kodin 180102 mbetje humane etj*”, me fond limit 481 200 leke pa tvsh, dhe procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me Nr.REF-47662-01-17-2020 me objekt Loti 1 “*Mbetje spitalore që përfshin kodin 180101 dhe 180103 age, bisturi etj*”,

me fond limit 7,410,000 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.

II.2. Në datën 23.01.2020 operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

- *Jemi njohur me dokumentat e tenderit me Nr.REF-47658-01-17-2020 Lot 1 Nr.Ref-47662-01-17-2020/ Lot 2 Nr.Ref-47664-01-17-2020 të publikuara në SPE më datë 20.01.2020. Me anë të kësaj ankese kërkojmë të rivlerësohen dhe të ndryshohen disa nga kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit si vijon:*
- *Në lidhje me ndarjen në lote : AK Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat e ka ndarë këtë procedurë të trajtimit të mbetjeve spitalore në 2 Lote: Loti 1 Mbetje Spitalore që përfshin kodin 180101 dhe 180103 age, bisturi, etj dhe Lot 2 Mbetje të rrezikshme spitalore që përfshin kodin 180102 mbetje humane etj.*
- *Në kreun II neni 9 pika 5 e VKM nr.914 datë 29.12.2014 parashikohet shprehimisht:Kontrata ndahet në lote kur përbëhet nga punë, mallra, shërbime homogjene ose të ngjashme dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje ti siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret vecanërisht për të nxitur pjesmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.*
- *Në VKM nr.798 datë 29.09.2010 Për miratimin e rregullores për adminsitrimin e mbetjeve spitalore në kreun I pika 1 dhe 2 qëllimi dhe objekti përcaktohet: Kjo rregullore përcakton procedurat rregullat dhe standartet teknike për adminsitrimin e mbetjeve spitalore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit. Mbetje spitalore janë mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve ku përfshihen mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme të cilat renditen në paragrafin 18 të vendimit nr.99 datë 18.02.2005 të vendimit të KM Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve. k) Mbetje e rrezikshme përfshijnë mbeturinat e infektuara , patologjike shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretës të infektuar.*
- *Gjithashtu në VKM nr.798 datë 29.09.2010 Për miratimin e rregullores për adminsitrimin e mbetjeve spitalore në kreun IV Leja mjedisore dhe Akt miratimi higjeno sanitar parashikohet shprehimisht 10.1 Grumbullimi, trnsportimi, përpunimi, dhe asgjesimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente , shtetërore , personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë q ëjanë pajisur me lejen përkatëse për ushtirmin e kësaj veprimtarie. 10.2. Leja e veprimtarisë së mësipërme është e vlefshme në shkallë vendi dhe miratohet nga Ministri i Mjedisit Pyjeve dhe Adminsitrimin të Ujrave . 10.3. Inspektoriati Sanitar Shtetëror pas ekspertimit higjeno shëndetësor lëshon akt miratim higjeno sanitar për ushtrimin e veprimtarisë.*
- *Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit për të dyja lotet vihet re se kjo procedurë ka për qëllim asgjesimin e mbetjeve të rrezikshme të autoritetit kontraktor , mbetje të cilat janë si bisturitë , shiringa, instrumenta të mprehtë përvec 180103 me kod 180101; Pjesë të trupit dhe organe përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut përvec 180103 me kod 180102; Mbetjet, grumbullimi dhe asgjesimi*

i të cilave kërkon trajtim të vecantë për të parandaluar infeksionet me kod 180103 të cilat referuar VKM nr.798 datë 29.09.2010 Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore dhe konkretisht në Kreun I pika 1 dhe 2 gërma k rezulton se bëjnë pjesë tek mbetjet e rrezikshme të cilat kërkojnë metoda dhe trajtime të vecanta për asgjësimin e tyre.

- *Referuar VKM nr.798 datë 29.09.2010 Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore vëren se në Kreun i pika 1 dhe 2 gërma k thuhet se: Mbetje të rrezikshme përfshijnë mbeturinat e infektuara , patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive dhe tretës të infektuar. Nisur nga sa më sipër si dhe referuar specifikimeve teknike rezulton se mbetjet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor për asgjësimin në këtë procedurë prokurimi bëjnë pjesë tek mbetjet e rrezikshme të parashikuara në VKM e sipërcituar.*
- *Ndarja në lote e procedurës së prokurimit Lot më vete për mbetjet në kategorinë 180101 dhe 180103 dhe Lot më vetë për mbetjet që përfshihen në kategorinë 180102 jo vetëm nuk është e justifikuar nga neni 9 pika 5 e VKM nr.914 dtaë 29.12.2014 por edhe do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësi duke e komplikuar edhe realizmin me sukses të kontratës. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga KPP në Vendimet si vijon: 835/2018, 98/2019, 14/2019, 54/2019.*
- *Për arsyet e mësipërme kërkojmë që realizimi i shërbimit për trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve të rrezikshme spitalore të mos prokurohet nëpërmjet një procedure të ndarë në lote por në një procedurë të vetme.*

- *Në lidhje me kriterin 2.1.2 të shtojcës 7 në Lotin 1. Në këtë kriter nga AK është kërkuar: Leje mjedisore të tipit B me kodin III.1.B të miratuar nga MM ku të përfshihen kodet 180101, 180103 në pëpruthje me objektin e prokurimit ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim. Në lidhje me këtë pikë në Vendimin nr.11/2020 KPP ka konstatuar se ndryshe nga mbetjet anatomike me kod 180102 që duhen trajtuar vetëm me metodën e incenerimit të pajisur me Leje Mjedisore të Tipit A me kod III.1.C për kategoritë e mbetjeve që mund të trajtohen me metodën e autoklavimit 180101, 180103 dhe 180104 për të lejuar konkurrencën mund të lejohet disponimi jo vetëm i lejes së tipit B sic është kërkuar por edhe i Lejes së tipit A. Edhe Ligji për Lejet e Mjedisit i cituar nga KPP për mbetjet që trajtohen me metoda të tjera përveç incenerimit psh autoklavim parashikon që mund të lëshohet edhe leje e tipit B edhe leje e tipit A pra për këto kategori që trajtohen me autoklavim mund të pranohet leja e tipit A ose leja e tipit B. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që të ndryshohet pika 2.1.2 në shtojcën 7 të lotit 1 si vijon: Operatori ekonomik duhet të disponojë leje mjedisore tipi B me kod III.1.B ose leje mjedisore të tipit A me kod III.1.C së bashku me akt miratimin përkatës dhe licencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore) që të përfshijnë mbetjet me kod 180101 dhe 180103 ku procedura e asgjësimit të jetë autoklavim.*

- *Në lidhje me kriteret 2.1.1 dhe 2.1.2 të shtojcës 7 Loti 2. Në këto kritere nga AK është kërkuar: Licencë profesionale lëshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B (e mbetjeve të rrezikshme spitalore) ku të përfshihen mbetjet me kodet 180102 ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim . Leje Mjedisore e tipit A me kodin III.1.C*

të miratuar nga MM ku përfshihen kodet 180102 në përputhje me objektin e prokurimit ku procedura e asgjесimit të jetë autoklavim. Referuar VKM nr.798 datë 29.09.2010 rezulton se asgjесimi i mbetjeve të rrezikshme me kod 180102 (mbetje anatomike) 180109 (mbetje farmaceutike/ilace të skaduara) duhet të realizohen me metodën e incenerimit. Gjithashtu në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 Për lejet e mjedisit ashtu edhe VKM nr.798 datë 29.09.2010 në një instalim incenerimi nga autoritetet përkatëse lëshohet vetëm leje mjedisore e tipit A (III.1.C) për të gjitha volumet e instalimet. Qëndrimi i mësipërm është mbajtur edhe nga KPP me vendimin nr.11/2020. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që kriteret 2.1.1 dhe 2.1.2 të shtojcës 7 Loti 2 kur procedura të rishpallet e bashkuar të modifikohet si vijon: Licencë profesionale lëshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B (e mbetjeve të rrezikshme spitalore) ku të përfshihen mbetjet me kodet 180102 ku procedura e asgjесimit të jetë Incenerim. Leje Mjedisore e tipit A me kodin III.1.C të miratuar nga MM ku përfshihen kodet 180102 në përputhje me objektin e prokurimit ku procedura e asgjесimit të jetë Incenerim.

- Në lidhje me kriterin 2.3.9 të shtojcës 7 në Loti 1 i njëjtë me kriterin 2.3.8 të shtojca 7 në lotin 2. Në këtë kriter autoriteti ka kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me kontratë qeraje noteriale një peshore elektronike automjetesh me kapacitet jo më pak se 10 ton vërtetuar kjo me faturë tatimore blerje , dokument kalibrimi të mjeteve peshuese dhe foto të saj. Në lidhje me këtë kriter KPP në raste të ngjashme vendim 11/2020 ka mbajtur qëndrimin se referuar volumit të mbetjeve që do të evadohen grafikut të mbledhjes dhe shtrirjes kohore që ka ky shërbim disponimi i kësaj peshoreje me kapacitet 10 ton është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në tejkalim të asaj çfarë është nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që ky kriter ose të hiqet ose kërkesa për peshore elektornike automjetesh ose të hiqet fare ose të zëvendësohet me kërkesë për një peshore të kalibruar mallrash me kapacitet minimal 200 ton.

II.3. Me shkresën nr.339 prot datë 29.01.2020, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit ku ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës si më poshtë:

- Në lidhje me ankesën tuaj të mos ndarjes së kësaj procedure në lote ju bëjmë me dije se ankesa juaj nuk pranohet.
- Në pikën 2.1.2 të shtojcës 7 në Lot 1 AK ka kërkuar: Leje mjedisore te Tipit B me kodin III.1.B. te miratuar nga Ministria e Mjedisit ku te përfshihen kodet 180101,180103 ne përputhje me objektin e prokurimit, ku procedura e asgjесimit te jete Autoklavim, AK vendos që ky kriter të ndryshohet si më poshtë:
Leje mjedisore te Tipit B me kodin III.1.B. ose Leje Mjedisore të tipit A me kodin III.1.C te miratuar nga Ministria e Mjedisit ku te përfshihen kodet 180101,180103 ne përputhje me objektin e prokurimit, ku procedura te jete Autoklavim.
- Në pikën 2.1.1 dhe 2.1.2 të shtojcës 7 në Lot 2 AK ka kërkuar:License Profesionale leshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B (e mbetjeve te rrezikshme spitalore) ku

te përfshihen mbetjet me kodet 180102, ku procedura e asgjesimit te jete Autoklavim, AK vendos që ky kriter të ndryshohet si mëposhtë:

Licencë profesionale lëshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B ose Leje Mjediore të tipit A me kodin III.2.C (e mbetjeve të rrezikshme spitalore) të miratuar nga MM ku të përfshihen mbetjet me kodet 180102 ku procedura të jetë Autoklavim, Incenerim.

- *Në lidhje me kriterin 2.3.9 të shtojcës 7 në Lot 1, i njëjtë me kriterin 2.3.8 të shtojcës 7 në Lot 2 ku AK ka kërkuar që OE ofertues të ketë në pronësi ose me kontratë qeraje noteriale një peshore elektronike automjetesh me kapacitet jo më pak se 10 ton vërtetuar kjo me faturë tatimore blerje, dokument kalibrimi të mjeteve peshuese si dhe foto të saj AK Spitali Berat vendos që ky kriter të bëhet si më poshtë:
OE ofertues të ketë në pronësi ose me kontratë qeraje noteriale një peshore elektronike të kalibruar të përshtatshme për peshim sipas objektit të kontratës vërtetuar kjo me faturë tatimore blerje si dhe foto të saj.*

II.4. Në datën 06.02.2020 pala ankimuese “V.A.L.E Recycling” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.552 prot., datë 17.02.2020 protokolluar me tonën me nr.150/2 datë 19.02.2020 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” shpk “realizimi i shërbimit për trajtimin e të gjitha kategorive të mbetjeve të rrezikshme spitalore të mos prokurohet nëpërmjet një procedure të ndarë në lote por në një procedurë të vetme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

1	2	3	4	5	6
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia e pritshme	Çmimi	vlera
	<i>Loti 1 Mbetje spitalore qe perfshin kodin 180101 dhe 180103 age bisturi etj.</i>	kg	26000		
	<i>Loti 2 Mbetje spitalore qe perfshin kodin 180102 mbetje humane etj</i>	Kg	1200		
Çmimi Neto)					
TVSH (%)					
Çmimi Total					

1. Mbetjet spitalore duhet të asgjësohen ne një impiant per incinerim I cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e këtij shërbimi sipas ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011, VKM Nr. 798 date 29.09.2010, ligjit Nr. 8934 date 05.09.2002, VKM Nr. 99 date 18.02.2005, ligjit Nr.9010 date 13.02.2003, ligjit 9537 date 18.05.2006.

-Mbetje te mprehta (instrumente të mprehta të përdorura, si për shembull: age, shiringa, bisturi, brisqe, pajisje të përziera, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme) KODI 18 01 01 dhe mbetje me potencial infektiv (tamponë, fasho, pambuk të ndotur me gjak, tamponë, fasho të ndotur me lengje trupore, qeset e gjakut për transfuzion, sistemet e kateterëve, pjesë trupi të padallueshme (të vogla) / mostra indesh, tuba dhe filtra dialize, pelena nga pacientë të infektuar, shiringa të ndotura me gjak, tuba të ndotur me gjak, ampula plastike të ndotura me gjak, doreza kirurgjikale të përdorura/maska/përparëse) KODI 18 01 03 do të asgjësohen sipas VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”:

- Shtojca 3) “Metodat per trajtim dhe asgjesim”, Pika 2) Me autoklavim, Germa c) Presion – Avull – Copetim si dhe

- Shtojca 5) “Standarte teknike per incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”.

Kjo metodë e mbeshtetur edhe në Udhëzimin Kombëtar “Per Menaxhimin e Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore” dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhezuesin Kombetar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”, Seksioni 7.1, Tabela 1.

-Mbetjet anatomike, (pjesë të trupit dhe organe, placenta dhe pjesë nga Laboratori Anatomio – Patologjik) KODI 18 01 02 do të asgjësohen sipas VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore”

- Shtojca 3) “Metodat per trajtim dhe asgjësim”, Pika 1) “Incenerim”, si dhe

- Shtojca 5) “Standarte teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”.

Kjo metodë e mbështetur edhe në Udhëzimin Kombëtar “Per Menaxhimin e Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore” dhe sipas percaktimeve te bera ne Udhezuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”,Seksioni 7.1, Tabela 1.

2. *Terheqja e mbetjeve do te behet sipas nevojave te AK. Mbetjet do te merren nga kontraktuesi pra Autoritetit Kontraktor dhe transporti i mbetjeve do të bëhet me automjetin e posacem dhe ambllazhin perkates duke respektuar standartin sipas VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” si dhe Udhezuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”*

- Shtojca 4) “Kushtet që duhet të respektojë transportuesi i mbetjeve spitalore infektuese”

3. *Asgjesimi do te realizohet ne zbatim te VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” si dhe Udhezuesin Kombëtar “Administrimi i sigurt i Mbetjeve Spitalore”*

4. *Operatori do të instaloje një frigorifer (banak frigoriferik) në ambjentet e Spialit Rajonal Berat me kapacitet 150 – 250 litra dhe temperaturë -18°C për ruajtjen e mbetjeve të lëngshme dhe të ngurta te kodit 180102 dhe do ta mirmbaje ate deri ne perfundim te kontrates.*

a. Te sigurohet disinfektimi i frigoriferit dhe ambientit ku eshte instaluar.

5. *Operatori do të sigurojë Qeset plastike, kontenieret nje ose disa perdorimesh plastike sipas standarteve te OBSH dhe te VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8;8 te kreut III, si dhe ne Udhezuesin Kombëtar te “Administrimit te sigurt te mbetjeve spitalore“,te certifikuar CE,*

- Kreu III) “Trajtimi i Mbetjeve Spitalore”, Pika 8.4) në përputhje me Shtojcen 2.A) “Etiketa e Konteinereve”

- Kontenieret duhet te jene nje ose disa perdorimesh dhe kur jane disa perdorimesh duhet te sigurohet larja dhe dizinfektimi I tyre ne cdo riperdorim.

- Te kene te stampuar logon nderkombetare per mbetjet e rrezikshme infective.

- Kontenieret duhet te jene ma kapacitet si me poshte:

- Perafersisht 3.5 l -6.5 l per mbetjet prerese dhe shpuese.

- Perafersisht 40 l -60 l per mbetjet infective dhe anatomo- patologjike.

- *Qeset nje perdorimeshe te jene me kapacitet perafersisht 20 kg.*
 - *Te jene kunder rrjedhjes dhe te papershkrueshem ndaj lageshtires dhe te forte per te parandaluar grisjen ose carje ne kushte normale perdorimi.*
 - *Duhet te jene te tille qe te mbyllen qe te parandalojne derdhjen e permbajtjes gjate transportit.*
6. *Mbetjet e mbledhura në kontenitoret përkates prane AK do të peshohen ne peshoren e cila disponohet nga Operatori Ekonomik në prani te dy paleve.*
 7. *Operatori Ekonomik dhe Perfaqesuesit e Spitalit Rajonal Berat per çdo dorëzim mbetjesh tek operatori për asgjësim, do të mbajnë “Dokumentin e Dorëzimit të Mbetjeve të Rrezikshme”, sipas VKM 371, Date 11.06.2014, “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre”. Saktësia e plotesimit te dokumentit te dorezimit te mbetjeve Spitalore do te sigurohet nepermjet dokumentit te peshimit gjeneruar nga peshorja elektronike e automjeteve.*
 8. *Operatori Ekonomik paise AK me sinjalistike dhe tabela sinjalizuese te cilat tregojne prezencen e mbetjeve te rrezikshme ne ambientet e perkatese te AK ne mbeshtetje te VKM nr 798 date 29.09.2016 si dhe ne Udhezuesin Kombetar te " Administrimit te sigurt te mbetjeve spitalore ”*

III.1.2. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni, pika 2 prashikohet shprehimisht se: *“Qëllimi i këtij ligji është: 10 a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”*

III.1.3. Në kreun II, Neni 9, pika 5 e të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Kontrata ndahet në LOTE, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.”*

III.1.4. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në Kreun I, pika 1 dhe 2 Qëllimi dhe Objekti, parashikohet shprehimisht: *“Kjo rregullore përcakton procedurat, rregullat dhe*

standardet teknike për administrimin e mbetjeve spitalore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit”. a) “Mbetje spitalore” janë mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku përfshihen: mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat renditen në paragrafin 18 të vendimit nr.99, datë 18.2.2005 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”. k) “Mbetje e rrezikshme” përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretës të infektuar”.

III.1.5. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, në Kreun IV, “Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar”, parashikohet shprehimisht: 10.1. *Grumbullimi, transportimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shtetërore, personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë, që janë pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie. 10.2. Leja e veprimtarisë së mësipërme është e vlefshme në shkallë vendi dhe miratohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. 10.3. Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjienosanitar për ushtrimin e veprimtarisë.*

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit vihet re se kjo procedurë ka për qëllim asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, në Drejtorinë Rajonale të Spitalit Berat, mbetje të cilët janë si bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta me kod 18 01 01; Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03), me kod 18 01 02; Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të parandaluar infeksionet me kod 18 01 03; të cilat referuar VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore” dhe konkretisht në Kreun I, pika 1 dhe 2 gërma (k), rezulton se bëjnë pjesë tek mbetjet e rrezikshme të cilat duan metoda dhe trajtime të veçanta për asgjësim e tyre po ti referohemi shtojcës 3 të kësaj VKM.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit), pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

III.1.7. Në rastin konkret Komisioni gjykon se ndarja në lote e procedurës së prokurimit objekt ankimi nuk ka asnjë efekt negativ përkundrazi nxit konkurrencën, lejon pjesëmarrjen sa më të gjërë të operatorëve ekonomikë si dhe stimulon pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm në përputhje me parimet e LPP. KPP gjykon se pretendimi i ankimuesit për bashkimin e loteve të procedurës në një të vetme në rastin konkret nuk është i bazuar dhe mbetet tërësisht i paargumentar cënimi që i vjen operatorit ekonomik nga zhvillimi në mënyrë të ndarë i procedurave.

KPP sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 63 të LPP i cili parashikon shprehimisht se “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Në interpretim të këtij neni KPP gjykon se ankimuesi për të legjitimuar kërkesën e tij duhet, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në rastin konkret ndarja e procedurës në lote jo vetëm nuk çënon interesin e ankimuesit por përkundrazi lejon pjesmarrjen sa më të gjërë të operatorëve ekonomikë në përputhje me parimet e LPP dhe nxitjen e konkurrencës. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka përzgjedhur ndarjen në lote të procedurës duke mos shkelur asnjë dispozitë ligjore dhe në funksion të konkurrencës dhe pjesmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurën e prokurimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “Në lidhje me kriteret 2.1.1 dhe 2.1.2 të shtojcës 7 Loti 2. Në këto kritere nga AK është kërkuar: Licencë profesionale lëshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B (e mbetjeve të rrezikshme spitalore) ku të përfshihen mbetjet me kodet 180102 ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim . Leje Mjedisore e tipit A me kodin III.1.C të miratuar nga MM ku përfshihen kodet 180102 në përputhje me objektin e prokurimit ku procedura e asgjësimit të jetë autoklavim. Referuar VKM nr.798 datë 29.09.2010 rezulton se asgjësi i mbetjeve të rrezikshme me kod 180102 (mbetje anatomike) 180109 (mbetje farmaceutike/ilace të skaduara) duhet të realizohen me metodën e incenerimit. Gjithashtu në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 Për lejet e mjedisit ashtu edhe VKM nr.798 datë 29.09.2010 në një instalim incenerimi nga autoritetet përkatëse lëshohet vetëm leje mjedisore e tipit A (III.1.C) për të gjitha volumet e instalimet. Qëndrimi i mësipërm është mbajtur edhe nga KPP me vendimin nr.11/2020. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që kriteret 2.1.1 dhe 2.1.2 të shtojcës 7 Loti 2 kur procedura të rishpallet e bashkuar të modifikohet si vijon: Licencë profesionale lëshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B (e mbetjeve të rrezikshme spitalore) ku të përfshihen mbetjet me kodet 180102 ku procedura e asgjësimit të jetë Incenerim. Leje Mjedisore e tipit A me kodin III.1.C të miratuar nga MM ku përfshihen kodet 180102 në përputhje me objektin e prokurimit ku procedura e asgjësimit të jetë Incenerim” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 Loti 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.1. “kapaciteti ligjor profesional” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1.License Profesionale lëshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B (e mbetjeve të rrezikshme spitalore) ku të përfshihen mbetjet me kodet 180102, ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim.

2. Leje mjedisore te Tipit A me kodin III.1.C. te miratuar nga Ministria e Mjedisit ku te perfshihen kodet 180102 ne perputhje me objektin e prokurimit, ku procedura e asgjesimit te jete Autoklavim.

III.2.2. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drejtuar ankimuesit sqarohet se: Në pikën 2.1.1 dhe 2.1.2 të shtojcës 7 në Lot 2 AK ka kërkuar: Licencë Profesionale leshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B (e mbetjeve te rrezikshme spitalore) ku te perfshihen mbetjet me kodet 180102, ku procedura e asgjesimit te jete Autoklavim, AK vendos që ky kriter të ndryshohet si mëposhtë:

Licencë profesionale leshuar nga QKL ose QKB me kodin III.2.B ose Leje Mjedisore të tipit A me kodin III.2.C (e mbetjeve të rrezikshme spitalore) të miratuar nga MM ku të përfshihen mbetjet me kodet 180102 ku procedura të jetë Autoklavim, Incenerim.

Në ankesën drejtuar KPP ankimuesi pretendon se: Edhe pse autoriteti kontraktor ka bërë modifikime në kriter nuk është reflektuar saktë kërkesa jonë për ndryshim e kriterit pasi së pari AK nuk mund të shprehet që kërkon Licencë profesionale III.2.B ose Leje mjedisore tipi A me Kod III.2. C (vini re kodin e gabuar për lejen mjedisore nuk është III.2C por III.1.C), pasi licenca dhe leja nuk janë alternative të njëra tjetrës por komplementare.

Gjithashtu Udhëzuesi Kombëtar i Administrimit të sigurtë të mbetjeve spitalore i nxjerre në zbatim të VKM nr.798 datë 29.09.2010 , në këtë udhëzues në fq 21 jepet tabela 1 ku janë përcaktuar rrymat e ndryshme të mbetjeve dhe metodat për trajtimin dhe asgjesimin e secilës rrymë dhe rezulton se për mbetjet me kod 180102 që përfshijnë mbetjet anatomike, placenta, pjesë trupi dhe organe është përcaktuar si metodë ajo e asgjesimit me incenerim. Pra nisur nga sa më sipër AK për mbetjet me kod 180102 duhet të kerkojë Leje Mjedisore ku procedura të jetë me incenerim dhe jo sic e ka shprehur AK ku procedura duhet të jetë Autoklavim Incenerim.

III.2.3. Në nenin 46 pika.1, gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

III.2.4. Në Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, neni 23 pika 1 dhe 2, përcaktohet se: “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me

aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik”.

III.2.5. Në VKM Nr.914 datë 29.12.2014 neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 4 përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale autoriteti kontraktor kërkon” ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën .*

III.2.6. Në neni 4 “Sistemi i lejeve të mjedisit” të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, parashikohet shprehimisht:

“1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:

a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/A të këtij ligji;

b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji;

c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/C të këtij ligji.”

III.2.7. Në Vendimin Nr.538 datë 26.05.2009 “Për Licencat dhe Lejet nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” parashikohet se:

1. Lejet mjedisore të përcaktuara në 34 pika 5 e ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar bëjnë pjesë në kategorinë III.1 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon:

a) “Leje e thjeshte mjedisore” me kodin III.1.A;

b) “leje mjedisore” me kodin III.1.B;

c) “leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C.

III.2.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.9. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se pretendimi i ankimuesit lidhur me përcaktimin e gabuar nga ana e autoritetit kontraktor të kodit III.2.C lidhur me lejen mjedisore të tipit A është i drejtë. Autoriteti kontraktor ka gabuar në përcaktimin e kodit ndaj duhet të bëjë korigjimet

përkatëse duke përcaktuar Leje mjedisore të tipit A me kodin III.1.C në përputhje me dispozitat ligjore.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Ndërsa sa i takon pretendimit të ankimuesit se “AK nuk mund të shprehet që kërkon Licencë profesionale III.2.B OSE Leje mjedisore tipi A me Kod III.2. C (vini re kodin e gabuar për lejen mjedisore nuk është III.2C por III.1.C), pasi licenca dhe leja nuk janë alternative të njëra tjetrës por komplementare”, KPP gjykon se autoriteti gjatë modifikimit të kriterit ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të paraqesin në mënyrë alternative njëzën nga dokumentat e sipërcituara. Në këtë kuptim KPP gjykon se i takon autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret kualifikuese mjafton që të jenë në përputhje, proporcionale me objektin e prokurimit dhe jodiskriminuese.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.10. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues sa i takon metodës së asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme me kod 180102 vetëm me incenerim, KPP vëren se në specifikimet teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartazi se: -Mbetjet anatomike, (pjesë të trupit dhe organe, placenta dhe pjesë nga Laboratori Anatomo – Patologjik) KODI 18 01 02 do të asgjësohen sipas VKM 798, Datë 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 3) “Metodat për trajtim dhe asgjësim”, Pika 1) “Incenerim”, si dhe Shtojca 5) “Standarte teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”.

III.2.11. Në VKM nr. Nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore”, parashikohet se :

SHTOJCA 3 METODA PËR TRAJTIMIN DHE ASGJËSIMIN

1. Incenerim

2. Autoklavim: a) Presion, b) Presion – avull, c) Presion – avull – copëtim.

3. Sterilizim me mikrovalë

4. Sterilizim - UV

5. Trajtim kimik/dizinfektim: a) me shkumës të kloruar; b) me klor aktiv (klor të lirë); c) me peroksid hidrogjeni (H₂O₂); d) me glutinimin e proteinave nëpërmjet përdorimit të acideve; e) me ozon (O₃).

Ndërsa shtojca 5 e VKM sa më sipër parashikon metodat e asgjësimit dhe trajtimit të mbetjeve me djegje.

III.2.12. Referuar kthim përgjigjes së autoriteti kontraktor drejtuar ankimuesit bëhet me dije se kriteri modifikohet si vijon: Licencë profesionale lëshuar nga OKL ose OKB me kodin III.2.B ose Leje Mjedisore të tipit A me kodin III.2.C (e mbetjeve të rrezikshme spitalore) të miratuar nga MM ku të përfshihen mbetjet me kodet 180102 ku procedura të jetë Autoklavim, Incenerim.

III.2.13. Sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor në modifikimin e kriterit duke përfshirë dhe procedurën autoklavim nuk i është përmbajtur tërësisht specifikimeve teknike të hartuara nga ai vetë ku ka përcaktuar qartazi se Mbetjet anatomike, (pjesë të trupit dhe organe, placenta dhe pjesë nga Laboratori Anatomo – Patologjik) KODI 18 01 02 do të asgjësohen sipas VKM 798, Date 29.09.2010, “Për administrimin e mbetjeve spitalore” Shtojca 3) “Metodat për trajtim dhe asgjësim”, Pika 1) “Incenerim”, si dhe Shtojca 5) “Standarte teknike për incenerimin dhe autoklavimin e Mbetjeve Spitalore”.

KPP gjykon se për kategorinë e mbetjeve të rrezikshme me kod 180102 duhet të përcaktohet si metodë e asgjësimit metoda e incenerimit e cila është e detyrueshme/e preferuar për këto kategori mbetjesh.. Në këtë kuptim KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me dispozitat ligjore duhet të modifikojë kriterin e kualifikimit duke përcaktuar si metodën e vetme të trajtimit dhe asgjësimit të mbetjeve me kod 180102 metodën e Incenerimit e cila vjen në koherencë të plotë edhe me përcaktimet në specifikimet teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “*Në lidhje me kriterin 2.3.9 të shtojcës 7 në Loti 1 i njëjtë me kriterin 2.3.8 të shtojca 7 në lotin 2. Në këtë kriter autoriteti ka kërkuar: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në pronësi ose me kontratë qeraje noteriale një peshore elektronike automjetesh me kapacitet jo më pak se 10 ton vërtetuar kjo me faturë tatimore blerje , dokument kalibrimi të mjeteve peshuese dhe foto të saj. Në lidhje me këtë kriter KPP në raste të ngjashme vendim 11/2020 ka mbajtur qëndrimin se referuar volumit të mbetjeve që do të evadohen grafikut të mbledhjes dhe shtrirjes kohore që ka ky shërbim disponimi i kësaj peshoreje me kapacitet 10 ton është një kërkesë e ekzagjeruar dhe në tejkallim të asaj çfarë është e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate. Në rrethanat e mësipërme kërkojmë që ky kriter ose të hiqet ose kërkesa për peshore elektornike automjetesh ose të hiqet fare ose të zëvendësohet me kërkesë për një peshore të kalibruar mallrash me kapacitet minimal 200 ton*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ,

III.3.1. Referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor drjtuar ankimuesit sqarohet se *Në lidhje me kriterin 2.3.9 të shtojcës 7 në Lot 1, i njëjtë me kriterin 2.3.8 të shtojcës 7 në Lot 2 ku AK ka kërkuar që OE ofertues të ketë në pronësi ose me kontratë qeraje noteriale një peshore elektronike automjetesh me kapacitet jo më pak se 10 ton vërtetuar kjo me faturë tatimore blerje , dokument kalibrimi të mjeteve peshuese si dhe foto të saj AK Spitali Berat vendos që ky kriter të bëhet si më poshtë:*

OE ofertues të ketë në pronësi ose me kontratë qeraje noteriale një peshore elektronike të kalibruar të përshtatshme për peshim sipas objektit të kontratës vërtetuar kjo me faturë tatimore blerje si dhe foto të saj.

III.3.2. Në ankesën drejtuar KPP ankimeusi pretendon se: *Kjo kërkesë e jona është pranuar në parim nga AK por nuk është përcaktuar kapaciteti minimal i peshores së kërkuar.*

III.3.3. Sa më sipër KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin e kualifikimit duke hequr përcaktimin në lidhje me peshën. Sa i takon pretendimit të ankimuesit për përcaktimin e kapacitetit minimal të peshores, KPP gjykon se në nenin 63 pika 4 gërma “b” të *lex specialis* parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk kundërshton një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, përsa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar vendosjen e kapacitetit minimal të peshores, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kriterë të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit për publikimin e shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi për lotin 1 dhe lotin 2 (për pretendimet e pranuar nga autoriteti kontraktor) KPP e gjen të drejtë. Sikundër u pasqyrua edhe më lart autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës së paraqitur nga ankimuesi por nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, KPP vëren se autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumentave. Në këtë kuadër KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë., duhet të japë sqarimet e nevojshme për operatorin ekonomik ankimues lidhur me kriterin e vendosur në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe këtë sqarim në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së duhet ta publikojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, duhet të publikojë shtojcën për modifikim të dokumentave të tenderit duke reflektuar kërkesat e pranuar si dhe duke mbajtur në konsideratë njëherazi edhe konstatimet në këtë vendim.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “V.A.L.E Recycling” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr.REF-47664-01-17-2020 me objekt Loti 2 “Mbetje spitalore qe perfshin kodin 180102 mbetje humane etj”, me fond limit 481 200 leke pa tvsh, dhe procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me Nr.REF-47662-01-17-2020 me objekt Loti 1 “Mbetje spitalore qe perfshin kodin 180101 dhe 180103 age, bisturi etj”, me fond limit 7,410,000 leke pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 30.01.2020 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentat e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “V.A.L.E Recycling” shpk.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 149 Protokoli, Datë 06.02.2020

Nr.150 Protokoli; Datë 06.02.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

